



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 14, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 3, te Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, e konform nenit 6, pika 3, lidhur me nenin 8 të Rregllores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe neneve 15, 29, pika 2 te Statutit të Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë----- miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

JEPET PËLQIMI- për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 1, (një) deri në 15, (pesëmbdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës, si vijon:

- 1.1 Parcela **P-72116045-00984-1** me sipërfaqe të përgjithshme prej **369310m²**, sipas certifikatës së pronës **nr. 984-2026**, datës 26.04.2026, zona kadastrale **Studëncan**, vendi i quajtura **“Trav/Çestok”** e evidentuar në emër të Komuna eSuharekës.
- 1.2 Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen për dhënien në shfrytëzim **S=38599.58m²**, sipas skices Nr.1 për ushtrimin e veprimtarisë për nevoja biznisore
- 1.3 Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen për dhënien në shfrytëzim **S=11441.28.58m²** sipas skices Nr.2 për ushtrimin e veprimtarisë për nevoja biznisore.

Neni 2

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastrë dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës se paluajtshme të Komunës, që të zhvilloj procedurat e ankandit publik, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” dhe Rregurores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, kjo Rregullore hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI